
AKT THEMELIMI DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ANDEN” SHPK

EMËRTIMI – SELIA – KOHËZGJATJA

NENI 1.

KRIJIMI, EMËRTIMI I SHOQËRISË.

1.1 Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “ANDEN” Shpk në vijim e quajtur “Shoqëria”.

1.2. Shoqëria themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar identifikuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 2.

SELIA.

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. Tirane, DR. Rurale 2, Nr. Pasurie 176/1/ND, Zona kadastrale 2376, Tirane.

2.2 Me vendim të Asamblesë së Ortakëve mund të hape zyra përfaqësie, degë, dhe/ose të krijoje filiale brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3.

KOHËZGJATJA.

3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të papërcaktuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, duke filluar nga rregjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 4.

OBJEKTI I SHOQËRISË.

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:

Import, eksport, tregti me pakicë të karburanteve, vajrave lubrifikantë, lëndëve djegëse, import ,eksport automjeteve , servis automjeteve, lavazh automjeteve, gomisteri, tregti të artikujve të ndryshëm, tregti me shumicë e pakicë të mallrave ushqimorë dhe industrialë, pjesë këmbimi etj. Transport karburanti dhe lëndë djegëse, transport mallra të ndryshëm, bar - restorant, hoteleri. Të gjitha shërbimet e pagesave



4.2 Për të arritur objektin te saj, Shoqëria, me vendim te Asamblesë mund te realizojë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare apo të huaja.

4.3 Shoqëria, dhe me qëllim arritjen e objektit te saj, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo ndërmarrje të tjera, si dhe të kryeje çdo veprim tregtar që do ta konsideroje të nevojshëm.

KAPITALI. PASURIA DHE FINANCIMI I SHOQËRISË

NENI 5. KAPITALI THEMELTAR.

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000(njëqind mijë) Lekë, i ndarë në 2 kuota. Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 6. ORTAKËT.

6.1 Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortakët:

- Daniel Shuaipi, shtetas shqiptar, i lindur më datë 24.05.1974, në Erseke, identifikuar me nr dokumenti personal H40524053V, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 50 000 lekë, që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Silvana Shuaipi, shtetase shqiptare, e lindur më datë 23.11.1979, në Berat, identifikuar me nr dokumenti personal H96123119B, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë 50 000 lekë, që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 7. TRANSFERIMI I KUOTAVE.

7.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme pa miratim paraprak të asamblesë së ortakëve.



7.2 Transferimi i kuotave duhet të realizohet në përputhje me ligjin dhe të regjistrohet në QKB sipas parashikimeve ligjore.

NENI 8.

FINANCIMI I SHOQËRISË.

8.1. Shoqëria me qëllim arritjen e objektit të saj, do të kërkojë financimin nëpërmjet mënyrave ligjore si kredi bankare, hua, financim nga ortakët dhe çdo formë tjetër ligjore.

NENI 9.

ORGANET E SHOQËRISË.

9.1 Organet e Shoqërisë janë:

- Administratori,
- Asambleja e Ortakëve.

NENI 10.


ADMINISTRATORËR

FUNKSIONET DHE KOMPETENCAT.

10.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator. Administratori është i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet tregtare të shoqërisë pa kufizim kompetencash, përveç atyre që ligji, akti i themelimit dhe statutija ngarkon Asamblesë së Ortakëve.

10.2 Administratori i shoqërisë kryen administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë. Shoqëria ka si administrator zotin Daniel Shuaipi, shtetas shqiptar, i lindur më datë 24.05.1974, në Erseke, identifikuar me nr dokumenti personal H40524053V, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

10.3 Administratori ka të gjitha kompetencat për përfaqësuar shoqërinë në marrëdhënie me të tretët. Ai vepron në emër të shoqërisë dhe nënshkruan çdo dokument të shoqërisë. Administratori nuk ushtron kompetencat që ligji ose



aktet e shoqërisë ja japin shprehimisht Asamblesë së Ortakëve. Administratori emërohet për një afat 5 vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

10.4 Administratori mund të autorizoj një person të kryejë veprim ne QKB si depozitim aktesh, vendimesh, bilance, statutit dhe çdo akte tjetër.

10.5. Administratori përfiton shpërblim/pagesa për punën e tyre me në masën e përcaktuar me vendim të asamblesë së ortakëve.

10.6. Administratori ka të drejtë ti delegojë aksionerit të gjitha të drejtat sikur të ishte ai vet ne lidhje me të gjitha institucionet financiare, drejtoritë e tatimeve, bankat etj .

NENI 11.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE.

11.1. Asambleja e Ortakëve është organi me i larte i shoqërisë dhe vendos për çdo çështje qe ligji ose ky statut ia rezervon asaj. Vendimet e Asamblesë janë te detyrueshme te zbatohen nga organet e shoqërisë.


11.2. Mbledhjet e Asamblesë se Ortakëve organizohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

11.3. Asambleja zhvillohet ne mënyrë te rregullt dhe vendos ne mënyrë te rregullt sipas kuorumit te parashikuar nga ligji.

11.4. Mbledhjet e Asamblesë zhvillohen normalisht ne selinë e shoqërisë por, me vendim të saj in Asambleja mund te mblidhet edhe ne një vend tjetër brenda ose jashtë Shqipërisë.

11.5. Ortakët njoftohen për mbledhjen e asamblesë te paktën 7 dite përpara dhe duhet te marrin njoftimin per datën, orën, vendin, rendin e ditës dhe te marrin kopjen e dokumenteve që lidhen me rendin e ditës.

11.6. Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve mund të thirren nga Administratori/administratorët, ose nga subjekte të parashikuar ne ligj.



NENI 12.

VITI FINANCIAR.

12.1. Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor.

12.2. Bilanci i shoqërisë mbahet në përputhje me ligjin, miratimi dhe cdo veprim tjetër merret në përputhje me parashikimet ligjore.

NENI 13.

PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË.

13.1. Procedura e likuidimit e parashikuar ne ligjin nr. 99 01, date 22.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" zbatohet ne rastin e prishjes se shoqërisë.

13.2. Shoqëria priset ne rastet e mëposhtëme: me vendim të asamblesë; me hapjen e procedurave të falimentimit; me vendim gjykate; dhe për çdo arsye tjetër parashikuar në akte të shoqërisë ose në legjislacionin shqiptar.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE


NENI 14.

LIGJI I ZBATUESHËM.

14.1. Shoqëria do te kryeje veprimtarinë e saj ne përputhje me këtë statut dhe me parashikimet e ligjeve shqiptare. Për sa nuk është parashikuar ne këtë statut do te zbatohet ligji shqiptar nr. 9901, date 22.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

14.2. Ky akt themelimi dhe statut hartohet dhe nënshkruhet ne 5 kopje origjinale sot më 07.04.2022, në Tiranë.


Ortaku



Daniel Shuaipi



Ortaku



Silvana Shuaipi

